

Q Ë N D R I M P U B L I K

Mos shpërdorimi i burimeve shtetërore si dhe sjellja korrekte dhe e paanshme e nëpunësit të administratës publike, thelbësorë për sigurimin e vullnetit të pacënuar të qytetarit në ushtrimin e së drejtës së votës

Më datë 13 janar, katër muaj përpara ditës së votimit për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023, nisën një sërë detyrimesh e kufizimesh ndaj institucioneve publike me synim ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore për përfitim elektoral. Kufizimet përfshijnë ndalimin në një masë të konsiderueshme të promovimit të veprimtarisë së këtyre institucioneve, punësimin apo largimin nga puna, etj.

Përgjatë katër muajve në vijim deri në ditën e zgjedhjeve, Kodi Zgjedhor përcakton edhe detyrimin për të raportuar për çdo aktivitet publik të institucioneve publike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka përgjegjësinë të ndalojë ato aktivitete për të cilat gjykon se bien në kundërshtim me ligjin.

Këto detyrime ligjore dhe të tjera aplikohen për herë të parë në një proces zgjedhor lokal të përgjithshëm, ndërkohë që u aplikuan edhe në zgjedhjet e pjesshme vendore të 6 marsit 2022.

Shpërdorimi i burimeve shtetërore dhe financimi i subjekteve zgjedhore ishin dy nga çështjet më problematike të evidentuara në proceset e mëparshme zgjedhore, të cilat u dakordësuan për tu adresuar në Kodin Zgjedhor mbi bazën e Marrëveshjes Politike të 5 qershorit 2020.

Megjithë vullnetin e shprehur dhe qëllimin e qartë të miratimit të dispozitave përkatëse ligjore për të forcuar, së pari, parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore për avantazh elektoral nga ata që janë në pushtet, aplikimi i tyre në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 evidentoi pamjaftueshmërinë e tyre për ta parandaluar fenomenin.

Raportet e organizatave vëzhguese vendase apo të organizmave ndërkombëtarë theksuan se përdorimi i burimeve shtetërore për avantazh elektoral ishte një nga problematikat më të theksuara të zgjedhjeve të fundit parlamentare¹.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹ [Raporti Përfundimtar i KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021](#), faqe 6: Maxhoranca hyri në këto zgjedhje me përparësinë e të qenit në kontroll të plotë të institucioneve publike, në nivel qendror e lokal, çka i dha asaj përparësi në procesin zgjedhor dhe zbehu dukshëm vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë përgjatë gjithë procesit.

[Raporti Përfundimtar i ODIHR për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021](#), faqe 1: Partia qeverisëse përfitoi avantazhe të rëndësishme nga të qenit pushtet, duke përfshirë edhe përmes kontrollit të administratave lokale dhe shpërdorimit të burimeve administrative.

Vëzhguesit deklaruan se detyrimet ligjore u injoruan masivisht në frymën e tyre, ndërkohë që edhe zbatimi i gërmës së ligjit çaloi në mënyrë të theksuar², **duke vendosur precedentë negativë për proceset në vijim, sikurse u pa më pas edhe gjatë zgjedhjeve vendore të pjesshme të 6 marsit 2022.**

Aktualisht vendi po shkon drejt Zgjedhjeve Vendore të 14 majit 2023 në gjendjen kur një parti politike kontrollon e vetme qoftë shumicën në Kuvendin e Shqipërisë, qoftë ekzekutivin, qoftë thuajse të gjitha bashkitë e vendit.

Në situatën kur, deri më tani, nuk pati asnjë reformim ligjor dhe asnjë reflektim institucional në qasjen e mazhorancës për sa është raportuar e denoncuar dhe nisur nga precedentët e vendosur e hapat e nisur ndërkohë, **shprehet shqetësimi se tendenca për të përdorur burimet shtetërore për qëllime elektorale do të vazhdojë e çohet edhe më tej**, duke i sjellë vendit dhe procesit shtetformues demokratik dëme të pallogaritshme.

Fushata zgjedhore duket se ka nisur, pavarësisht se ligjërisht ajo duhet të nisë vetëm 30 ditë përpara zgjedhjeve. **KRIIK konstaton se vendimmarrjet e fundit të qeverisë janë haptazi me natyrë elektorale³**, pavarësisht dobisë dhe domosdoshmërisë që kanë ato në përmbajtje për shtetasit shqiptarë.

Masat e marra janë një detyrim i shtetit dhe i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ndaj mirëqënies së qytetarëve të vet, ndaj duhet të parashikohen, procesohen e përcillen tek publiku si të tilla prej anëtarëve të qeverisë e lidershipit të mazhorancës në tërësi.

Madje në këtë fushatë të nisur nuk munguan sërish shfaqjet e tepruara të propagandës elektorale lidhur me masat e marra, ndërkohë që **shpërndareshin pako me dhuratat për familjet përfituese në nevojë, duke iu publikuar atyre identitetin dhe fotot, përfshirë edhe fotot e fëmijëve të mitur** pa asnjë shirit mbulimi në fytyrë⁴.

² [Raporti Përfundimtar i KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021](#), faqe 8: Mekanizmi që synonte të adresonte problemin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore, një prej risive të sjella nga amendimet ligjore të korrikut 2020, dështoi në qëllimin e vet dhe u kthye në një formalitet burokratik pa efekt real në praktikë. Institucionet shtetërore dështuan madje e shpërfillën në një masë të konsiderueshme të raportojnë sipas kërkesave të kuadrit ligjor.

Totali i institucioneve të evidentuara në Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator që mbartnin. detyrimin për të raportuar Aktivitetet e veta ishte 344. Por nga këto, vetëm 51 (më pak se 15%) raportuan të kishin kryer aktivitete gjatë periudhës katër mujore (në total 1.254 aktivitete). Shifra e institucioneve që nuk kanë raportuar është më i lartë, duke marrë në konsideratë se lista e institucioneve në Vendimin nr. 9 nuk është shteruese. Nga ana tjetër, pavarësisht se kuadri rregullator kërkonte që aktivitetet të raportoheshin së paku pesë ditë përpara kryerjes së tyre, rreth 72% të aktiviteteve të raportuara (906/1254) janë raportuar më pak se pesë ditë përpara. Një pjesë e konsiderueshme (8%) janë raportuar ditën në të cilën aktiviteti do të zhvillohej, madje ka të tilla të raportuara pasi aktiviteti kishte ndodhur (39 aktivitete).

³ Ndihma ekonomike e fund vitit 2022, miratuar me VKM nr. 897, 898 dhe 899 datë 29.12.2022, e quajtur nga qeveria “Pakoja e Madhe” konsiderohet e tillë. Përpos ndihmës të alokuar në grupe të ndryshme të shoqërisë nëpërmjet saj, Këshilli i Ministrave i alokoi në fund të vitit fonde shtesë disa Bashkive në vend, nëpërmjet VKM-ve nr. 767 – 798, nr. 801 – 804, 813, të miratuara në datën 12 dhjetor 2022.

Në përfundim të mandatit, Bashkia Tiranë nisi sistemimin dhe asfaltimin e një sërë rrugësh në territorin e bashkisë, duke e justifikuar këtë aksion me fonde të mbetura pa shpenzuar në përfundim të vitit 2022. Ndërkohë, sipas deklaratave të [Kryeministrit Rama](#) dhe [Zv. Kryeministres Balluku](#), edhe të ardhurat e mbledhura nga taksa e jashtëzakonshme për prodhuesit e energjisë do të përdoren për mbështetje të shtresave vulnerabël. Nuk është e qartë nga deklaratat se kur do të shpërndahen këto të ardhura, por nënkuptohet se do të jetë në pranverë.

⁴ Vetëm postimet në faqen zyrtare të Kryeministrit për shpërndarjen e dhuratave për familjet në nevojë janë rreth 20, ndërkohë që ato janë zyrë rishpërdarë (share) mesatarisht nga 340 herë të tjera secila, si dhe kanë marrë nga rreth 6 mijë pëlqime secila. Këtu nuk llogariten postimet e tjera të mundshme nga vetë ministrat dhe shpërndarjet që mund t’iu jenë bërë më pas atyre.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol thelbësor në kontrollin e veprimtarive publike të institucioneve dhe parandalimin e përdorimit të tyre për qëllime elektorale.

KRIIK vlerëson iniciativën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për t'u kujtuar institucioneve publike detyrimet e tyre ligjore⁵ gjatë periudhës 13 janar – 13 maj 2023, por ndërkohë vëren se deri në datën 12 janar është raportuar nëpërmjet e-mail-it vetëm një aktivitet⁶ i Bashkisë Kolonjë. Kjo do të thotë se deri në datën 17 janar prezumohej se nuk do të kishte asnjë aktivitet publik prej institucioneve, dhe fakti që të tillë janë zhvilluar, sikurse edhe evidentohet nga pasqyrimi i deritanishëm në ndërfaqen e raportimit⁷ në faqen e internetit të KQZ-së, tregon se detyrimi për të raportuar është shkelur tanimë nga ato institucione që kanë kryer të tilla aktivitete.

Pavarësisht vonesave në funksionalitetin e sistemit në ndërfaqen e raportimit, **KRIIK nxit KQZ-në për plotësimin e mëtejshëm të tij me fusha plotësimi shtesë⁸**, në të cilat institucionet të mund të detajojnë informacion sa më të plotë mbi aktivitetet që parashikojnë të organizojnë.

Ky plotësim në raportimin e kërkuar është i domosdoshëm në rradhë të parë për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi të KQZ-së në kontrollin e këtyre veprimtarive, gjë që nuk është bërë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe ato të datës 6 mars 2022. Gjithashtu, ai përbën ndihmesë edhe për efikasitetin e shqyrtimit të ndërmarrë në funksion të hetimeve administrative që mund të bëhen bazuar në indiciet apo denoncimet e depozituara në KQZ.

Ndryshimet ligjore të vitit 2020, në linjë me rritjen e efikasitetit të mekanizmit të ndërtuar për kontrollin dhe ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore, **sollën si risi mundësinë e palëve të treta për të kryer denoncime** lidhur me raste të përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale.

Sikurse ka bërë publike në raportet e tij, **KRIIK ka vërejtur një qasje penguese dhe të anshme politikisht të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) të KQZ-së**, kundër frymës së ligjit ndaj denoncuesve të abuzimeve, duke pretenduar që ata të sillnin prova për gjetjet e veta, duke e lënë kështu të gjithë barën e provës tek denoncuesi. Proceset e shqyrtimit të denoncimeve u shndërruan në procese gati të mirëfillta gjyqësore, ku KAS e konsideronte veten si një gjykatë, e cila shqyrton mbi pretendimet nga njëra anë të qytetarit dhe nga ana tjetër të institucionit shtetëror të akuzuar, së bashku me kandidatët dhe partitë politike.

⁵ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - [KUIJTESË – Mbi veprimtarinë e institucioneve publike katër muaj përpara datës së zgjedhjeve](#), datë 12.01.2023.

⁶ Nga komunikimi i KRIIK me administratën e KQZ është referuar marrja e vetëm këtij raportimi, por ky aktivitet ende nuk është shfaqur në ndërfaqen e raportimit në faqen e internetit të KQZ-së.

⁷ Nga sa pasqyrohet në ndërfaqen e raportimit në faqen e internetit të KQZ-së deri në çastin e publikimit të këtij Qëndrimi, evidentohet se janë 11 njoftime të cilat janë në shkelje të afatit 5 ditor përpara organizimit të aktivitetit të parashikuar për tu organizuar. Konkretisht, Bashkia Tiranë 7 njoftime, Bashkia Durrës 2 njoftime, Kryeministria 1 njoftim, Kuvendi i Shqipërisë 1 njoftim.

⁸ KRIIK, [Rekomandime lidhur me ndërfaqen e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore të ngritur prej KQZ-së](#), dërguar KQZ-së më datë 14.01.2023.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në këtë qasje, pavarësisht se KAS vihej në dijeni të shkeljeve dhe abuzimeve prej funksionarëve të administratës shtetërore apo subjekteve zgjedhore, ai **nuk mori masa të investohej vetë si institucion dhe si pjesë e KQZ-së për të hetuar plotësisht dhe deri në fund rastin**, por i la shkeljet të paprovuara e rrjedhimisht edhe të pasanksionuara, duke cënuar procesin, efikasitetin e mekanizmit e të ligjit, si dhe **vendosur precedentë negativë e nxitur vazhdimësinë e sjelljeve të paligjshme**.

KRIIK, në vazhdimësi të qëndrimit të tij, nxit Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si një institucion trilateral, që të orientohet sipas frymës së ligjit dhe zbatojë atë vetëm në interesin më të mirë dhe të përgjithshëm të qytetarëve, duke **konsideruar dhe vlerësuar përmbajtësisht çdo denoncim të paraqitur dhe duke marrë vetë si institucion barrën e provës dhe jo duke ia lënë atë denoncuesit**⁹.

Në **realitetin demokratik shqiptar**, sikurse është bërë me dije edhe nga qëndrimet e mëparshme të KRIIK, **mirëfunksionimi i ligjit dhe i institucionit është i lidhur ngushtësisht me vullnetin politik të titullarit dhe forcës politike të tij**, si dhe të frymës që kjo e fundit përçon si forcë qeverisëse.

Përdorimi i burimeve shtetërore nuk mund të ndalet tërësisht, madje ai mund të mos ekzistojë më si një problem madhor i zgjedhjeve në vend, **në rast se do të manifestohet një vullnet politik i plotë dhe i qartë për ndalimin e tij nga forca politike në pushtet**.

KRIIK u bën thirrje zyrtarëve të lartë të maxhorancës qeverisëse se është e domosdoshme që ata të vetpërbahen dhe të tregojnë maturi të lartë, duke mos përdorur ofiqin zyrtar për avantazh zgjedhor, në frymën e ndarjes së partisë nga shteti, sipas parimeve të **Dokumentit të Kopenhagës**¹⁰.

Mazhoranca socialiste duhet të kuptojë qartazi se është mandatar për administrimin e shtetit me mandat të caktuar e të kufizuar në kohë, dhe çdo politikë dhe shërbim që bëhet për qytetarët dhe në interes të tyre, **është një detyrim i shtetit shqiptar dhe jo një privilegj** që Partia Socialiste dhe mazhoranca qeverisëse u bën atyre.

Sot Shqipëria është një nga vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, këtij forumi të lartë botëror në të cilin nxiten dhe shqyrtohen parimet më të larta të lirive dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjes së demokracisë së popujve dhe lirisë.

Po ashtu, vendi ka nisur zyrtarisht negociatat për anëtarësim në Bashkimin Europian, union i cili rrezaton nivelin më të lartë të zbatimit të lirive e të drejtave të njeriut, si dhe të parimeve e standardeve demokratike.

Në këto rrethana, paraqitet akoma më shumë **si një detyrë madhore e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe mazhorancës aktuale**, që të sigurojë e ngrëjë lart kredibilitetin e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, si një vend i cili në këto pozicione të marra gjendet natyrshëm, pasi manifeston tërësisht parimet e normat demokratike të një shteti ligjor, garantimin e lirive e të drejtave të njeriut, si dhe ka një sistem shtetëror e demokratik funksional e të gjallë, ku **më së pari shteti garanton të drejtën për një**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁹ KRIIK, [Rekomandime për përmirësimin e kuadrit rregullator ligjor për zgjedhjet vendore 2023](#), dërguar KQZ-së më datë 10.01.2023.

¹⁰ Paragrafi 5.4.

zgjedhje të lirë dhe të fshehtë, dhe ku parandalohet çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo, dhe si ka votuar¹¹.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe se **organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre¹².**

Në këtë kuadër, **nevojitet së pari që, të gjithë nëpunësit e administratës publike në të gjitha nivelet, pavarësisht nëse kanë statusin e nëpunësit civil ose jo, të demonstrojnë ligjshmëri dhe paanësi, si dhe të mos lejojnë të përdoren apo të shpërdorjnë pozicionin zyrtar për qëllime elektorale, në asnjë formë.**

Për nëpunësit civil, kuadri ligjor ka një parashikim të qartë dhe të plotë duke iu lejuar, përveç kandidimit, vetëm pjesëmarrjen në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar, por pa u bërë protagonist në to dhe pa manifestuar me materiale e mjete të propagandës elektorale.

Atyre iu ndalohet shprehja publikisht e preferencave dhe bindjeve politike, përfshirë postimin në mediat dhe rrjetet sociale, si dhe bërja fushatë për partitë politike ose kandidatët, apo edhe e ashtuquajtura fushatë derë më derë.

Kuadri ligjor e veçanërisht ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike” parashikon detyrime të qarta **jo vetëm për nëpunësit publik, por edhe për nëpunësit e kompanive private që kryejnë shërbime publike¹³, duke kërkuar prej tyre ndër të tjera ligjshmëri, korrektësi, ndershmëri e mbi të gjitha paanësi politike, ku kjo e fundit është thelbësore dhe buron nga pluraliteti politik që qëndron në themel të shtetit¹⁴.**

Nëpunësi publik nuk duhet ta përdorë ose të lejojë ta përdorin detyrën zyrtare të tij, në mënyrë të tillë që të nxisë ose të detyrojë ndonjë person tjetër, përfshirë edhe vartësit, për të pasur ndonjë përfitim financiar ose të çdo lloji tjetër me interes personal¹⁵.

¹¹ Rekomandimi i dytë prioritar i [Raportit Përfundimtar të ODIHR për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021, faqe 30.](#)

¹² Neni 15 i Kushtetutës.

¹³ [Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003](#), “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 2 “Fusha e veprimit”, pika 3. “Dispozitat e këtij ligji përbëjnë detyrim edhe për personat e punësuar nga organizatat private që kryejnë shërbime publike”.

¹⁴ Po aty, Neni 3 “Parime të përgjithshme të etikës”, pika “1. Në kryerjen e funksioneve, nëpunësi i administratës publike duhet të respektojë parimet si më poshtë:

a) të kryejë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
b) të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike;
c) në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;

ç) të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët që u shërben, dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij;
d) nuk duhet të veprojë arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personalë të të tretëve;

dh) të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;

e) të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet;

¹⁵ Po aty, Neni 12.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ai duhet duhet të përdorë mjetet që i ofron pozicioni i punës vetëm për realizimin e detyrave të tij dhe jo për qëllime personale.

Gjithashtu ai duhet ta **përdorë kohën e punës në mënyrë efektive** për realizimin e detyrave zyrtare dhe **nuk mund ta përdorë këtë kohë për asnjë qëllim tjetër**¹⁶.

Një administratë shtetërore e çliruar nga anshmëria politike dhe realisht e pavarur është kusht për ndërtimin dhe konsolidimin e një administrate korrekte dhe profesionale, **duke zhbërë kështu sistemin e patronazhit politik të ngritur dhe punësuar paligjshmërisht në rradhët e administratës publike.**

Për më tepër, që një administratë e tillë mund të jetë bazë për furnizimin me burime njerëzore të administratës zgjedhore të pavarur të nevojshme për administrimin e proceseve zgjedhore pas vitit 2025 e në vazhdim, sikurse parashikon Marrëveshja Politike e 5 qershorit 2020.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së kuadrit ligjor aktual për të parandaluar plotësisht keqpërdorimin e administratës për avantazh elektoral, si dhe **të nevojës emergjente për shprehjen e një vullneti politik të qartë** në zhbërjen e praktikave negative të mëparshme, **KRIIK i bën thirrje Kryeministrit të Shqipërisë Sh.T.Z. Edi Rama, njëkohësisht lider i maxhorancës dhe Kryetar i Partisë Socialiste që, në linjë me praktikën e mëparshme**¹⁷, **të nxisë dhe miratojë një Vendim të Këshillit të Ministrave** i cili të plotësojë elementët e munguar të kuadrit ligjor rregullator aktual dhe të parashikojë ndërmarrjen e hapave konkretë për parandalimin plotësisht të këtij fenomeni, duke përfshirë ndër të tjera edhe kufizimin e nxjerrjes së akteve nënligjore që mund të perceptohen se përdoren për qëllime elektorale për periudhën deri në ditën e zgjedhjeve.

Gjithashtu, duke qenë se propaganda elektorale tanimë kryhet në masë të konsiderueshme në mediat sociale, dhe ekziston tashmë një përcaktim i qartë dhe i plotë i vendosur nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil¹⁸ që **i konsideron postimet në media sociale me natyrë elektorale, qoftë ndarjen e postimeve ashtu edhe pëlqimin e tyre, në shkelje të ligjit për nëpunësin civil**¹⁹, KRIIK gjykon se është e domosdoshme që pjesë e VKM-së të jetë shtrirja e këtij detyrimi për të gjithë nëpunësit e

¹⁶ Po aty, Neni 13, 14.

¹⁷ - [Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 283, datë 10.05.2019](#), për “Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019”.

- [Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 1.6.2017](#), “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”.

¹⁸ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në shkresën nr. 458, datë 05.04.2021, drejtuar grupeve të monitorimit të burimeve njerëzore të institucioneve pjesë e shërbimit civil, interpretoi në mënyrë më të plotë kufizimet e parashikuara nga ligji duke e shtrirë fushën e tyre të veprimit edhe në mediat sociale.

Sipas përcaktimit të Komisionerit: “... ndarja apo pëlqimi i materialeve elektorale të subjekteve politike në mediat sociale (*Facebook, Twitter, Instagram*) në llogaritë personale të punonjësve civilë përbën shkelje të detyrimit për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike”.

¹⁹ Sipas ligjit “Për nëpunësin civil” dhe Kodit Zgjedhor, nëpunësit e administratës publike, në nivel qendror apo lokal, e kanë të ndaluar të marrin pjesë në aktivitete elektorale gjatë orarit zyrtar të punës, si dhe, në rast pjesëmarrjeje jashtë këtij orari, nuk duhet të kryejnë veprime të cilat manifestojnë haptazi përkrahjen për ndonjë forcë politike.

Përpos pjesëmarrjes fizike, me interpretim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u përcaktua edhe kufizimi për të mos shprehur publikisht preferencat apo bindjet politike nga nëpunësit publikë në rrjetet sociale.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

administratës publike, si një zbatim më i plotë e i saktë i ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Një rregullim i tillë paraqitet mëse i nevojshëm duke i dhënë interpretimin e duhur frymës së Kushtetutës dhe ligjit dhe mënyrës së zbatimit të tyre, **duke i bërë të qartë çdo nëpunësi të administratës publike por edhe çdo nëpunësi që kryen shërbime publike²⁰**, se të drejtat dhe liritë kushtetuese të tyre, liria politike personale lidhet me pjesëmarrjen e lirë të tyre në aktivitetet politike që preferojnë dhe me të drejtën për të zgjedhur apo për t’u zgjedhur, dhe **jo me shpërdorimin e pozicionit apo titullit që mbajnë, për të ndikuar opinionin politik të të tjerëve apo orientimin e votës së tyre.**

Në përfundim, KRIIK iu bën thirrje të gjithë institucioneve shtetërore që të marrin masat e nevojshme dhe të ngrenë mekanizma realisht funksionalë që të parandalojnë shpërdorimin e burimeve shtetërore për avantazh elektoral përgjatë kësaj periudhe, deri në ditën e zgjedhjeve, përfshirë por pa u kufizuar në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Gjithashtu, KRIIK u bën thirrje qytetarëve, aktorëve të shoqërisë civile, përfshirë gazetarët dhe median në tërësi që të denoncojnë e bëjnë publike çdo shkelje të vërejtur duke investuar mekanizmat që kuadri ligjor ka vendosur në dispozicion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo edhe mekanizma të tjerë institucionale

Tiranë, më 16 Janar 2023!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

²⁰ Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 2 “Fusha e veprimit”, pika 3. “Dispozitat e këtij ligji përbëjnë detyrim edhe për personat e punësuar nga organizatat private që kryejnë shërbime publike”.